



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

Mësimdhënia e

DREJTËSISË TRANZICIONALE NË KOSOVË

MANUAL PËR MËSUESIT



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

TABELA E PËRMBAJTJES

Rreth Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë	3
Hyrje	5
1.Konteksti i Kosovës	7
1.1 Kosova nën RSFJ 1944 - 1989	7
1.2 Diskriminimi etnik dhe ndarja 1989 - 1997	8
1.3 Konflikti i Armatosur 1998 - 1999	9
1.4 Periudha nën administrim të OKB-së 1999-2008	15
2. Ballafaqimi me të Kaluarën dhe Drejtësia Tranzicionale	17
2.1 Definimi i Drejtësisë Tranzicionale	17
2.2 Fushëveprimi i Drejtësisë Tranzicionale	17
2.3 Shtyllat e Drejtësisë Tranzicionale	18
2.4 Drejtësia Tranzicionale në Praktikë	33
2.5 Burime relevante rreth Drejtësisë Tranzicionale	36

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit “Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes gjithëpërfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë”, dhe nga organizata National Endowment for Democracy përmes projektit “Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik”.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Fondit për të Drejtën Humanitarë Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës apo të National Endowment for Democracy.

RRETH FONDIT PËR TË DREJTËN HUMANITARE KOSOVË

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë) është themeluar në Prishtinë në maj të vitit 1997, nga aktivistja e të drejtave të njeriut, znj. Nataša Kandić, si degë e Fondit për të Drejtën Humanitare.

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë vepron si një organizatë e pavarur që nga prilli i vitit 2011. FDH Kosovë vazhdimisht kontribuon në aftësimin e Kosovës për të vendosur sundimin e ligjit dhe zbatimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale, në mënyrë që të zhvillojë një shoqëri të drejtë që përballet me të kaluarën dhe i respekton të drejtat e çdo qytetari.

FDH Kosovë punon në dokumentimin e fakteve, të cilat e ndihmojnë shoqërinë e Kosovës të ballafaqohet me të kaluarën e saj të dhunshme. Organizata synon t'i kundërvihet mohimit dhe manipulimit politik të humbjeve njerëzore, dhe e synon sigurimin e integritetit dhe transparencën e gjykimeve të krimeve të luftës.

Deri në shpërthimin e armiqësive midis forcave të sigurisë serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në shkurt të vitit 1998, FDH Kosovë ishte i fokusuar në dokumentimin e represionit policor ndaj shqiptarëve të Kosovës, duke hetuar rastet e torturës, të ndalimit të paligjshëm, ftesave masive të shqiptarëve për “biseda informative”, dhe në gjykimet politike. Pas intensifikimit të konfliktit, FDH Kosovë zhvendosi vëmendjen në dokumentimin e vrasjeve dhe zhdukjeve të shqiptarëve të Kosovës, si dhe në zhdukjen e pjesëtarëve të grupeve të tjera etnike. Pas ndërhyrjes së NATO-s në vitin 1999, FDH Kosovë ka lëvizur zyrën e saj në Mal të Zi, ku ka vazhduar punën e dokumentimit me shqiptarët e Kosovës, të cilët ishin dëbuar nga Kosova. Me arritjen e marrëveshjes së paqes të vitit 1999, që i dha fund luftës, FDH Kosovë u kthye në Prishtinë dhe e filloi dokumentimin e krimeve të kryera nga forcat serbe gjatë ndërhyrjes së NATO-s. Pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, FDH Kosovë ka filluar të hetoj rrëmbimet, zhdukjet dhe vrasjet e serbëve, ashkalinjëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve.

Sot, FDH Kosovë vazhdon përpjekjet e saj për monitorimin e procedurave gjyqësore në lidhje me pasojat e

konfliktit të fundit. Përveç monitorimit dhe raportimit mbi gjykimet, FDH Kosovë përfshihet në mënyrë aktive edhe në gjetjen e viktimave dhe përfaqëson familjet e tyre në gjykatat në Kosovë dhe në Serbi. Elementi i tretë themelor i aktiviteteve të FDH Kosovë është përhapja e njohurive mbi drejtësinë tranzicionale brenda komuniteteve profesionale dhe jo-profesionale.

HYRJE


Në një botë, e cila evoluon vazhdimisht, është e domosdoshme të sigurohet që ngjarjet e të kaluarës të mos harrohen, veçanërisht në rajone që kanë përjetuar konflikte dhe ndryshime të mëdha politike dhe shoqërore. FDH Kosovë, që nga themelimi i tij, në vazhdimësi ka kontribuar në ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme dhe në sigurimin e të drejtave të viktimave duke promovuar të drejtat e tyre në drejtësi, për të ditur të vërtetën, dëmshpërblime dhe në garancione të mospërsëritjes. Për Kosovën, një vend me një histori komplekse, udhëtimi drejt një të ardhmeje më të ndritshme fillon me të kuptuarit e të kaluarës. Rëndësia e mësimit të së kaluarës, e trajtimit të saj dhe roli i drejtësisë tranzicionale në këtë proces nuk mund të nënvlerësohet. Rëndësia e kësaj përpjekjeje qëndron në aftësinë e saj për të udhëzuar rininë e Kosovës drejt një të ardhmeje të karakterizuar ngapaqja e qëndrueshme dhe bashkëjetesa. Kuptimi i të kaluarës, përballja me kompleksitetet e saj dhe vlerësimi i natyrës së shumanshme të historisë është i domosdoshëm për ndërtimin e një shoqërie më të harmonizuar. Drejtësia tranzicionale luan një rol kyç në këtë proces, duke ofruar një platformë, e cila lejon individët nga komunitetet e ndryshme të ballafaqohen me padrejtësitë e kaluara, e ndihmon procesin e drejtësisë dhe kontribuon në procesin e pajtimit.

Ky manual është një përgjigje ndaj nevojës urgjente për një edukim të kompletuar, të balancuar dhe të saktë mbi kontekstin e Kosovës. Duke u nisur nga përvoja e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë) në fushën e edukimit jo-formal mbi drejtësinë tranzicionale, që nga viti 2013, ky manual adreson mungesën e njohurive tek studentët në lidhje me të kaluarën e vendit. Aktualisht, studentët ekspozohen shpesh ndaj narrativave të njëanshme, që jo vetëm pengojnë të kuptuarit e tyre, por gjithashtu i kontribuojnë ndarjes.

Duke përdorur këtë manual, mësuesit mund të pajisin studentët e tyre me aftësitë e mendimit kritik, të nevojshme për të pyetur, reflektuar dhe për të marrë pjesë në ballafaqimin me të kaluarën. Kjo do të kontribuojë në nxitjen e një gjenerate që është më e pajisur për të promovuar dialogun, për të luftuar ndarjet dhe për të

marrë pjesë aktivisht në formimin e një të ardhmeje më paqësore për Kosovën. Ky manual do ju shërbejë të gjithë arsimtarëve të shkollave të mesme, të cilët e trajtojnë të kaluarën në lëndët e tyre përkatëse.

Përfundimisht, ky manual synon të fuqizojë edukatorët në Kosovë me njohuri dhe me mjete të nevojshme për të angazhuar studentët në një eksplorim kuptimplotë të së kaluarës. Në këtë mënyrë, ne mund të hapim rrugën për një të ardhme më të ndritshme dhe më harmonike, të bazuar në drejtësinë për viktimat.



Udhëtimi drejt një të ardhmeje më të ndritshme fillon me të kuptuarit e të kaluarës. Andaj, në vijim do të trajtohet konteksti i Kosovës që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e deri në shpalljen e pavarësisë së saj.

1.KONTEKSTI I KOSOVËS

1.1 Kosova nën RSFJ 1944 – 1989

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ) është formuar më 29 nëntor të vitit 1945 dhe kishte një organizim federativ, që përbëhej nga gjashtë republika: Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Sllovenia si dhe nga dy krahina: Kosova dhe Vojvodina.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova mbeti si krahinë e Serbisë në kuadër të RSFJ-së. Gjatë kësaj periudhe, shqiptarët e Kosovës ishin viktimë të shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave elementare të njeriut. Pavarësisht kufizimeve politike dhe përndjekjeve, lëvizjet studentore dhe udhëheqës politikë të

Kosovës bënë kërkesa të vazhdueshme në autoritetet jugosllave për përmirësimin e pozitës së popullsisë shqiptare në Kosovë. Më 1968, shpërthyen demonstratat e shqiptarëve në Kosovë, të cilët kërkuan të drejtat e tyre kombëtare, përdorimin e gjuhës shqipe në nivel institucional, përdorimin e flamurit kombëtar dhe e shtruan kërkesën për universitet në gjuhën shqipe. Në vitin 1974 është amendamentuar Kushtetuta e Jugosllavisë dhe për herë të parë Krahina Socialiste Autonome e Kosovës e kishte kushtetutën dhe kuvendin e saj, të cilat i dhanë premisa shtetërore. Si e tillë, ajo zotëronte të drejta pothuajse të barabarta si gjashtë republikat përbërëse socialistë të RSFJ-së.

Përkundër kësaj arritjeje, popullsia e Kosovës vazhdoi të mbetet më e diskriminuara në kuadër të ish-Jugosllavisë. Kjo pakënaqësi nxiti protestat studentore të Pranverës së vitit 1981, në të cilat si thirrje kryesorë is

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Sistemi politik i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ).

Kuptimi i termit "Krahinë Autonome".

Vlerësoni rëndësinë e protestave/demonstratave, duke marrë parasysh se ato janë mjete demokratike të reagimit shoqëror

hte shpallja e Kosovës republikë në kuadër të federatës jugosllave. Demonstratat vazhduan përgjatë viteve '80-të dhe të gjitha u shtypën me dhunë dhe u përcollën me arrestime të shumë veprimtarëve shqiptarë dhe të tjerë u detyruan ta lënë vendin.

1.2 Diskriminimi etnik dhe segregimi 1989 - 1997

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990.

Dëbimet masive të shqiptarëve nga puna.

Sistemi paralel i arsimit në Kosovë gjatë viteve të 90-ta.

Sistemi paralel i shëndetësisë në Kosovë gjatë viteve të 90-ta.

Më 23 Mars 1989, nën masa të rrepta policore, në Kuvendin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës u miratuan ndryshimet kushtetuese në Kushtetutën e Kosovës, ku me miratimin e tyre, më 28 Mars 1989 në Kuvendin e Serbisë, u hoq edhe efektivisht autonomia e Kosovës. Një projekt i tillë ishte një nga hapat e parë që Slobodan Miloševići ndërmoi menjëherë pas ardhjes së tij në pushtet në vitin 1989.

Pakënaqësia e popullsisë shqiptare ndaj këtij vendimi u shpreh përmes marsheve, protestave dhe veprimeve konkrete që u ndërmorën nga grupe të ndryshme të shoqërisë.

U organizuan demonstrata masive në të gjitha rajonet e Kosovës dhe, në anën tjetër, një grevë masive e urisë u organizua nga 1300 minatorët e Trepçës. Pastaj, më 2 Korrik të vitit 1990, deputetët e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nxorën Deklaratën Kushtetuese përmes të cilës shpallën Kosovën njësi të barabartë dhe të pavarur në mesin e republikave të tjera të RSFJ-së¹. Menjëherë pas shpalljes, delegatët e Kuvendit të Kosovës u përdoqën dhe shumë nga ata u larguan nga Kosova.

¹Për më shumë informata: <https://oralhistorykosovo.org/sq/constitutional-declaration-of-july-2-1990/>

Një vit më vonë, është organizuar referendumi mbarëpopullor, përmes të cilit Kosova u shpall e pavarur dhe sovrane dhe, pas një viti, përmes zgjedhjeve të vitit 1992, Ibrahim Rugova u zgjodh Kryetar i Kosovës, i cili ishte udhëheqës i rezistencës paqësore kundër masave të dhunshme të autoriteteve shtetërore serbe. Vetë referendumi dhe organizimi i zgjedhjeve kanë qenë pjesë e rezistencës paqësore, duke krijuar një sistem paralel, i cili nuk është njohur dhe pranuar nga regjimi serb.

Në pamundësi për të ushtruar pushtet efektiv dhe e përndjekur nga forcat serbe, qeveria e Kosovës u tërhoq duke dështuar të jep rezultate.

Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë gjatë kësaj periudhe mbeti jashtëzakonisht e vështirë. Gati të gjithë të punësuarit në sektorin publik u dëbuan nga puna, u mbyll Universiteti i Prishtinës si dhe shkollat e mesme në gjuhën shqipe, shtypi dhe radiotelevizioni. Për t'u përballur me këtë sfidë, shqiptarët ofruan shtëpitë e tyre për të zhvilluar arsimin dhe ndihmuan në hapjen e klinikave të shëndetit primar. Ndërkohë, u burgosën, u vranë dhe u keqtrajtuuan me mijëra shqiptarë, kurse një numër i madh i shqiptarëve të Kosovës u detyruan ta lëshojnë vendin dhe të kërkojnë azil në Evropën Perëndimore. Protestat studentore, ndonëse ishin ndërprerë në fillim të '90-ve, ato rinisën më 1 tetor 1997 dhe vazhduan edhe gjatë vitit 1998.

1.3 Konflikti i Armatosur 1998 – 1999

Gjatë viteve të 90-ta, filluan të përdoren edhe masa jo-paqësore, të cilat sollën edhe themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Intervenimi i NATO-s në Kosovë.

Eksperiencat personale gjatë qëndrimit si refugjatë në shtetet e rajonit apo zhvendosja brenda Kosovës gjatë periudhës së luftës.

Përfshirja e këtyre të dhënave në kurrikulat e sistemit edukativ.

PROPOZIM

Është e rëndësishme që nxënësit të takojnë familjarë që kanë qenë të moshës madhore në periudhën e luftës dhe të diskutojnë me ta rreth përvojave të tyre. Pastaj, nxënësit mund të shkruajnë një ese, jo më të gjatë se dy faqe, lidhur me këto diskutime.

për të plotësuar mungesën e rezultateve të pritshme nga masat paqësore. UÇK-ja, si një organizatë ushtarake e shqiptarëve të Kosovës, u themelua nga mesi i viteve të '90-të dhe deri në Nëntorin e vitit 1997 kreu sulme të fshehta ndaj forcave të armatosura policore dhe ushtarake serbe në Kosovë. Më 28 Nëntor të vitit 1997, pjesëtarë të kësaj organizate u shfaqën publikisht në fshatin Llaushë të Skënderajt, ku shfaqen edhe programin dhe qëllimet e UÇK-së.

Si datë zyrtare e fillimit të konfliktit të armatosur në Kosovë, njihet 28 Shkurti i vitit 1998, kur në fshatrat Qirez dhe Likoshan u përballën pjesëtarët e UÇK-së me forcat policore-ushtarake Serbe. Konflikti i armatosur në Kosovë u zhvillua në mes të UÇK-së, në njërën anë, dhe forcave policore serbe, ushtarake të RFJ-së dhe paramilitare serbe, në anën tjetër, si palë ndërluftuese dhe i njëjti zgjati deri në muajin qershor të vitit 1999, kur edhe u nënshkrua Marrëveshja e Kumanovës.

Shkeljet masive të drejtave të njeriut nga forcat serbe ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë morën vëmendjen e faktorit ndërkombëtarë. Të përballur me dështimin e negociatave për paqe dhe bllokimin e veprimeve multilaterale përmes Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndërmorën fushatën për bombardimin e RFJ-së në bashkëpunim me Aleancën Veri-atlantike, NATO-n. Të shtyrë nga qëllime humanitare, aleatët e NATO-s filluan më 24 mars të vitit 1999 sulmet ajrore ndaj caqeve ushtarake jugosllave për 78 ditë me radhë. Gjatë kësaj kohe, UÇK-ja vazhdoi konfrontimet ushtarake me trupat serbe.

Më 9 qershor të vitit 1999 u nënshkrua Marrëveshja e Kumanovës, e cila, ndër të tjera, parashihte edhe tërheqjen e forcave serbe dhe hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë. Këshilli i Sigurimit e miratoi Rezolutën 1244 (1999), e cila pezulloi qeverisjen e Beogradit mbi Kosovën, dhe nën të cilën Kosova u vendos nën administrimin e Misionit të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe e njëjta autorizoi një forcë paqeruajtëse të NATO-s për të garantuar paqen në Kosovë - KFOR (UNSC Resolution 1244, 1999).

Gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, mbi 1 milion persona u dëbuan nga vendi. Vetëm gjatë 9 javëve të para


pas fillimit të intervenimit të NATO-s, mbi 860,000 shqiptarë u larguan me dhunë nga Kosova drejtë shteteve fqinje: Shqipëri (444.600), Maqedoni të Veriut (344.500), dhe Mal të Zi (69.900) (UNHCR, 2000). Në anën tjetër, menjëherë pas përfundimit të luftës, mbi 200.000 serbë, romë dhe pjesëtarë të grupeve të tjera etnike u larguan nga Kosova (UNHCR, 1999).

Përveç dëbimit me dhunë të popullsisë, gjatë kësaj periudhe u kryen krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit duke u shkelur konventat dhe ligjet e luftës. Mbi 13.000 persona u vranë dhe/apo zhukën në periudhën Shkurt 1998 - Dhjetor 2000, prej tyre mbi 1600 persona rezultojnë akoma të zhdukur, me mijëra persona humbën gjymtyrët e tyre si pasojë e plagëve të marra, një numër i madh i grave dhe burrave ishin viktima të dhunës seksuale si mjet i luftës (OSCE 1999; HRC, 1999; Center for Disease Control, 1999; Kosovo Memory Book)

Fondi për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd dhe Fondi për të drejtën Humanitare Kosovë, që nga përfundimi i luftës në Kosovë kanë bërë dokumentimin e personave, të cilët kanë humbur jetën dhe/apo janë zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë në periudhën Janar 1998 - Dhjetor 2000. Të gjeturat preliminare në projektin


Libër Kujtimi i Kosovës e të cilat përfshijnë periudhën 1 Janar 1998 - 31 Dhjetor 2000 janë të pasqyruara më poshtë:

Gjithsej 13.535 persona janë vranë dhe/apo zhdukur me forcë në Kosovë gjatë periudhës Janar 1998 - Dhjetor 2000.




Të dhënat statistikore sipas kategorizimit të viktimave


Shqiptarë: 10.812 Persona




Serb: 2197 Persona




Romë, Ashkali dhe Egjiptas: 275 Persona




Boshnjak: 95 Persona




Të tjerë: 156 Persona



Statistikat sipas komunave ku kanë ndodhur vrasjet/zhdukjet



Sipas vendit (shtetit) të vdekjes



1.4 Periudha e pas Luftes 1999 - 2008

Rezoluta 1244 e vitit 1999 e nxjerrë nga Këshilli i Sigurimit ofroi një zgjidhje të përkohshme për statusin e Kosovës duke e vendosur territorin e saj nën administrimin e UNMIK-ut dhe duke instaluar një forcë të NATO-s në Kosovë për të garantuar paqe.

Menjëherë pas përfundimit të luftës, misioni i UNMIK-ut u angazhua në themelimin e institucioneve vetëqeverisëse dhe u angazhua që të garantohet sundimi i ligjit. Pastaj, në vitin 2001, menjëherë pas miratimit të Kornizës Kushtetuese të Kosovës nga UNMIK-u, u organizuan zgjedhjet e para të lira për herë të parë në historinë e Kosovës, ku qytetarët patën mundësi të

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM


Misioni i UNMIK-ut dhe krijimi i institucioneve të përkohshme.

Kujtimi i momentit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Mënyra e festimit të festës së shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës.

zgjedhin përfaqësuesit e tyre në bazë të shprehjes së lirë të vullnetit të tyre. Megjithatë, UNMIK-u vazhdoi të mbante kompetencat kryesore në pushtetin ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor.

Ndërkohë, në vitin 2007, Martti Ahtisari, si i dërguar i Kombeve të Bashkuara, prezantoi planin gjithëpërfshirës për Kosovën ku parashihej pavarësi e mbikëqyrtur me të drejta të zgjeruara për komunitetet pakice dhe sidomos për komunitetin Serb në Kosovë. Një vit më vonë, më 17 Shkurt të vitit 2008, në pajtueshmëri me këtë plan dhe duke u thirrur në Rezolutën 1244, Kosova shpalli pavarësinë e saj. Më 9 Prill 2008, u miratua Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila hyri në fuqi më 15 Qershor të vitit 2008 dhe me këtë u bë edhe transferimi i pjesës së kompetencave prej UNMIK-ut tek institucionet vendore.



Shoqëritë, të cilat janë pjesë e luftërave, konflikteve të brendshme të armatosura apo sistemeve autoritare janë viktime të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut. Në mënyrë që të arrihet një paqe e qëndrueshme dhe të garantohet një sistem qeverisës demokratik – këto shoqëri duhet të përballen me të kaluarën dhe t'i trajtojnë shkeljet masive të të drejtave të njeriut, të cilat kanë ndodhur në të kaluarën.

2.BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN DHE DREJTËSIA TRANZICIONALE

2.1 Definimi i Drejtësisë Tranzicionale

Drejtësia Tranzicionale përfshinë tërësinë e proceseve dhe të mekanizmave që lidhen me përpjekjet e një shoqërie për t'u përballur me një trashëgimi të abuzimeve të përmasave të mëdha në të kaluarën, për të siguruar llogaridhënie, drejtësi dhe pajtim. Këto procese mund të përfshijnë mekanizma ligjor dhe joligjor, me ose pa përfshirje ndërkombëtare, karakterizuar me ndjekje penale individuale, reparacione, gjetjen e së vërtetës, reforma institucionale, vetingun dhe shkarkime apo një kombinim të të njëjtave. (Raporti i OKB-se, S/2004/616, para. 8).

2.2 Fushëveprimi i Drejtësisë Tranzicionale

Fushëveprimi i Drejtësisë Tranzicionale duhet shikuar në dy aspekte kyçe. Sa i përket kontekstit, Drejtësia Tranzicionale aplikohet në situatat e post-konfliktit dhe ato post-autoritare. Kohët e fundit, mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale janë duke gjetur aplikim edhe në shtetet me paqe të qëndrueshme dhe demokraci të zhvilluar, por që në të kaluarën e largët kanë qenë përgjegjëse për shkelje masive të të drejtave të njeriut. Sa i përket aspektit të kohës, mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale gjejnë zbatim vetëm pasi luftimet dhe dhuna të kenë përfunduar.

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Kuptimi i termeve: paqe, drejtësi dhe pajtim.

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Kuptimi i termit konflikt i armatosur.

Kuptimi i termit sistem autoritar.

KOMENT:

Gjatë konflikteve të armatosura, civilët janë të mbrojtur nga konventat e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe ligjet e luftës.

aplikohet në situatat e post-konfliktit dhe ato post-autoritare. Kohët e fundit, mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale janë duke gjetur aplikim edhe në shtetet me paqe të qëndrueshme dhe demokraci të zhvilluar, por që në të kaluarën e largët kanë qenë përgjegjëse për shkelje masive të të drejtave të njeriut. Sa i përket aspektit të kohës, mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale gjejnë zbatim vetëm pasi luftimet dhe dhuna të kenë përfunduar.

2.3 Shtyllat e Drejtësisë Tranzicionale

Viktimat e abuzimeve masive të të drejtave të njeriut kanë të drejtë të shohin autorët e krimeve duke u dënuar, të dinë të vërtetën, të marrin dëmshpërblime dhe t'u garantohet mospërsëritja. Për tu arritur këto qëllime, Drejtësia Tranzicionale funksionon në bazë të katër shtyllave kyqe, përkatesishtë:

- 1.E drejta në Drejtësi;
- 2.E Drejta për të Ditur të Vërtetën;
- 3.E drejta në Reparacione dhe
- 4.Reformat Institucionale.

2.3.1 E Drejta në Drejtësi

Ndjekja dhe gjykimi i përgjegjësve të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, qoftë gjatë sistemeve autoritare apo gjatë konflikteve të armatosura, është obligim ligjor për shtetet në tranzicion.

Hetimet dhe gjykimet e udhëheqësve të lartë (qoftë politik apo ushtarak) ndihmojnë drejtpërdrejtë në forcimin e sundimit të ligjit dhe, po ashtu, dërgojnë një sinjal të fortë se krime të tilla nuk do të tolerohen në një shoqëri demokratike.

Gjykimet mbetën një kërkesë kyçe e viktimave. Ato shpeshëherë konsiderohen si një përgjigje e përbashkët ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve serioze. Kryesisht fokusohen në individët e veçantë dhe janë një hap më tutje në rikthimin e dinjitetit të nëpërkëmbur të viktimave dhe kthimin e besimit në sundimin e së drejtës.

Ndjekjet dhe gjykimet penale për krimet serioze të kryera në kohë të luftës ose në kohë të regjimeve autoritare mund të kryhen nga mekanizma të ndryshëm gjyqësorë, si:

- Gjykatat Vendore;
- Gjykatat Hibride;
- Tribunalet e Përkohshëm Penal Ndërkombëtar dhe
- Gjykatat e Përhershme Penale Ndërkombëtare.

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Rëndësia e denimit të personave përgjegjës për shkeljet masive të të drejtave të njeriut.

Ndjekjet penale për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë 1998-1999


Me ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë, janë marrë një numër i madh i mekanizmave gjyqësor vendor, ndërkombëtar dhe të përzier (gjykata hibride).

I. Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë


Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë është themeluar në vitin 1993 si përgjigje ndaj situatës së krijuar dhe krimeve që ishin duke ndodhur gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, respektivisht në Kroaci dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ky tribunal ka përfunduar punën e tij në dhjetor të vitit 2017 dhe para tij janë gjykuar kryesisht njerëzit përgjegjës të shkallëve më të larta të përgjegjësisë për krimet e kryera gjatë luftërave të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Të akuzuar për krimet e luftës në Kosovë: 15 persona




Të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për krimet e luftës në Kosovë: 8 persona




II. Gjykimet për krimet e luftës para gjykatave në Serbi

Deri në vitin 2002, Gjykatat e Qarkut kanë qenë përgjegjëse për gjykimin e krimeve të luftës. Ndërsa, që nga viti 2003, këtë përgjegjësi e ka Gjykata e Lartë, e cila është e vendosur në Beograd.

Të akuzuar për krimet e luftës në Kosovë: 67 persona




Të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për krimet e luftës në Kosovë: 17 persona



III. Gjykimet për krimet e luftës në Kosovë para gjykatave në Mal të Zi

Deri më tash, pranë gjykatave të rregullta në Malin e Zi janë proceduar dy raste për krimet e luftës në Kosovë.


Të akuzuar për krimet e luftës
në Kosovë: 9 persona



9

Malazezë

Të dënuar me aktgjykim të
plotfuqishëm: 1 person




1

Malazezë


IV. Gjykimi i krimeve të luftës nga gjykatat vendore në Kosovë

Ndjekja dhe gjykimi i krimeve të luftës në Kosovë ka kaluar në një varg mekanizmash të ndryshëm gjyqësorë. Me vendosjen e Kosovës nën administrimin e OKB-së, UNMIK-u kishte përgjegjësi ekskluzive për ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë deri me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Pas shpalljes së pavarësisë, në Kosovë është instaluar Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit – EULEX, të cilit, ndër të tjera, i është transferuar përgjegjësia për ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë. Pastaj, nga qershori i vitit 2014, përgjegjësia për ndjekjen dhe për gjykimin e krimeve të luftës filloi të transferohet tek mekanizmat gjyqësorë vendor dhe, nga qershori i vitit 2018, institucionet vendore gjyqësore kanë përgjegjësi ekskluzive në këtë aspekt. Përkatësisht, në maj të vitit 2015, në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) është krijuar Departamenti për Krimet e Luftës dhe, gjithashtu, në vitin 2019, në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës së Apelit, janë krijuar Departamentet Speciale, të cilat janë përgjegjëse për trajtimin e aktakuzave që vijnë nga PSRK e, në mesin e tyre, edhe të rasteve të krimeve të luftës në Kosovë.

Të akuzuar për krimet e luftës në Kosovë: 193 persona:



Të dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm për krimet e kryera në Kosovë: 47 persona




²Prej tyre 60 persona janë akuzuar në mungesë, gjatë vitit 2023

³Prej tyre 1 person është akuzuar në mungesë, gjatë vitit 2023.

Gjykimi i Krimeve të Luftës nga Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar


Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë një mekanizëm hibrid me qëllim të ndjekjes dhe gjyqimit të personave përgjegjës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera në Kosovë në periudhën 1998-2000. Themelimi i këtij mekanizmi gjyqësor ndërlidhet me dyshimet e ngritura për krime të luftës në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të vitit 2011, i njohur ndryshe edhe si raporti i Dick Marty-t. Kjo gjykatë ka mandat për ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, që janë kryer në periudhën 1998-2000 dhe që ndërlidhen me Raportin e Dick Marty-t. Gjithashtu, kjo gjykatë ka kompetencë për ndjekjen dhe gjykimin e rasteve që ndërlidhen me administrimin e drejtësisë. Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë të vendosura në Hagë, vepronë në bazë të legjislacionit të Republikës

Të akuzuar për krimet e luftës në Kosovë: 6 persona



6
Shqiptarë

Të dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm për krimet e luftës në Kosovë: 1 person



1
Shqiptarë

së Kosovës dhe kanë një mandat të përkohshëm.

2.3.2 E Drejta për të Ditur

Konfliktet e armatosura dhe sistemet autoritare përcillen me shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe individët kanë të drejtë të dinë të vërtetën lidhur me ngjarjet, në të cilat janë kryer këto shkelje. E drejta për të ditur është një nga shtyllat e Drejtësisë Tranzicionale dhe garantohet përmes një numri të madh të dokumenteve ndërkombëtare dhe kombëtare.

E drejta për të ditur mund të sigurohet përmes mekanizmave të ndryshëm ligjor dhe joligjor:

Komisionet e së Vërtetës: Komisionet e së Vërtetës janë mekanizma jo-gjyqësore, të cilët kanë për qëllim gjetjen e së vërtetës përmes rrëfimeve të viktimave, në njërin anë, dhe kryerësve të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, në anën tjetër. Komisionet e tilla formohen nga institucionet shtetërore dhe kanë një mandat të caktuar dhe mund të fokusohen në të gjitha shkeljet masive të të drejtave të njeriut apo në një kategori të caktuar të veprave penale. Pas përfundimit të mandatit të tyre, këto komisione dalin me një raport të përgjithshëm rreth narrativit të krijuar përmes përballjes së rrëfimeve të viktimave dhe personave përgjegjës. Në anën tjetër, raportet e tilla përfshijnë një numër të madh të rekomandimeve, të cilat i drejtohen institucioneve relevante me qëllim të kontribuimit në krijimin e një paqeje të qëndrueshme dhe mospërsëritje të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut në të ardhmen. Që nga viti 1974, mbi 40 komisione të tilla janë themeluar. Një nga mekanizmat e tillë më të njohur është, Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin i Afrikës së Jugut, i cili ka funksionuar në periudhën 1995-2002.

⁵Për më shumë informata: <https://www.usip.org/publications/1995/12/truth-commission-south-africa>

Mekanizmat e ndryshëm të dokumentimit: Në kuadër të gjetjes së të vërtetës, një rol kyç luajnë edhe iniciativat e ndryshme shtetërore dhe jo-shtetërore të dokumentimit të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut dhe ato të dokumentimit të viktimave si pasojë e këtyre shkeljeve. Iniciativat e tilla, ndër të tjera, përfshijnë: institutet shtetërore për dokumentimin e krimeve, komisionet shtetërore për njohjen e statusit të kategorive të ndryshme të viktimave, iniciativat e ndryshme akademike të dokumentimit dhe hulumtimit, iniciativat e shoqërisë civile të dokumentimit.

Iniciativat e deritanishme lidhur me gjetjen e së vërtetës në Kosovë

Instituti për Krime të Luftës: Instituti për Krime të Luftës në Kosovë është themeluar në vitin 2011 dhe është mbyllur në vitin 2018. Ky institut ka qenë një mekanizëm shtetëror për dokumentimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Një mekanizëm i tillë është mbyllur përmes një vendimi qeveritar me arsyetimin për mungesë të arritjes së rezultateve të pritshme nga ana e tij.⁶

Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë: Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë ishte iniciativë e ish-presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaqi, i cili është nisur në vitin 2017. Në vitin 2017 është krijuar grupi parapërgatitor, i cili ka mbajtur një varg diskutimesh konsultative me grupe të ndryshme të interesit dhe, gjithashtu, në kuadër të punës së këtij grupi punues është hartuar edhe akti normativ mbi rregullimin dhe funksionimin e këtij komisioni. Por, me dorëheqjen e presidentit Thaqi si pasojë e aktakuzës së ngritur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, puna rreth këtij komisioni ka stagnuar dhe nuk është ndërmarrë ndonjë hap drejtë themelimit të tij.⁷

Për më shumë informata: <https://kosovotwopointzero.com/themelimi-i-serishem-i-institutit-te-krimeve-te-luftes/>

⁷Për më shumë informata: <https://balkaninsight.com/sq/2022/07/29/a-ka-nje-te-ardhme-komisioni-per-te-verteten-dhe-pajtimin-ne-kosove/>

Instituti për krimet e kryera ne Kosovë: Themelimi i këtij mekanizmi është një iniciativë nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës e ndërmarrë në vitin 2021 dhe ka për qëllim dokumentimin institucional të krimeve që kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë. Ky mekanizëm është duke u themeluar përmes një ligji të veçantë, i cili është votuar më 13 Korrik të vitit 2023, gjë që ka sjellë edhe themelimin e Institutit.⁸

Komisioni shtetëror për dokumentim të trashëgimisë kulturore të shkatërruar nga forcat e armatosura serbe gjatë luftës së viteve 1998 – 1999: Themelimi i këtij mekanizmi është një iniciativë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit e Republikës së Kosovës e ndërmarrë në vitin 2021 dhe ka për qëllim dokumentimin institucional të dëmeve kulturore që janë shkatëruar nga forcat e armatosura serbe gjatë luftës në Kosovë.⁹

Komisionet e tjera Qeveritare në Kosovë: Në proces të gjetjes të së vërtetës, që nga përfundimi i luftës në Kosovë, janë krijuar një varg komisionesh qeveritare, të cilat kanë kontribuar në fusha të ndryshme të dokumentimit. Të tilla janë: Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve, invalidëve, pjesëtarëve dhe të internuarve të UÇK-së, Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, Komisioni për njohjen dhe verifikimin e statusit të burgosurve politikë, etj.

Dokumentimi nga Shoqëria Civile: Një rol të rëndësishëm në gjetjen e së vërtetës ka luajtur shoqëria civile. Që nga përfundimi i luftës në qershor të vitit 1999, organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë në procesin e gjetjes të së vërtetës përmes dokumentimit të krimeve, viktimave dhe shënimit të vendeve të krimit, që ndërlidhen me luftën në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Si organizata joqeveritare kyçe të angazhuara në procesin e dokumentimit mund të përmendim:

⁸ Për më shumë informata: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://hlc-kosovo.org/storage/app/media/Iniciativat%20aktuale%20Shtet%3%ABrore%20p%3%ABr%20Ballafaqim%20me%20t%3%AB%20Kaluar%3%ABn/Final%20Buletin%20-%20ALB.pdf>

⁹Po aty.

Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, etj.

KOMRA – Rrjeti për Pajtim: KOMRA është një iniciative rajonale e shoqërisë civile e filluar në vitin 2008, e cila ka për synim themelimin e një komisioni rajonal për të vërtetën. Por, si pasojë e mungesës së bashkëpunimit nga të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë, kjo iniciativë nuk është funksionalizuar ende. KOMRA synon të dokumentoj faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë nga data 1 janar e vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001.¹⁰

2.3.3 E Drejta në Dëmshpërblime

E drejta në dëmshpërblime është një aspekt jashtëzakonisht i rëndësishëm i ofrimit të drejtësisë për viktimat dhe, gjithashtu, një komponent thelbësor i Drejtësisë Tranzicionale. Dëmshpërblimet ndaj viktimave i kontribuojnë pranimit simbolik të humbjeve njerëzore dhe materiale, që kanë pësuar viktimat dhe, në anën tjetër, iu mundësojnë edhe një jetë më me dinjitet. Varësisht nga konteksti, dëmshpërblimet mund të ofrohen në forma dhe në mënyra të ndryshme:

Ndarja e dëmshpërblimeve sipas mënyrës së ofrimit:

Materiale: Të gjitha dëmshpërblimet që ofrohen në formë të pagesave në para të gatshme dhe përmes paketave të shërbimeve, të cilat përfshijnë mbështetje për arsimim, strehim, dhe shëndetësi njihen si dëmshpërblime materiale.

¹⁰Për më shumë informata: <https://www.recom.link/en/>

Simbolike: Të gjitha masat e përbashkëta jo materiale, duke përfshirë letrat formale të kërkim-faljes, ditët kombëtare dhe ndërkombëtare të përkujtimit, rivarrimi/varrimi i viktimave dhe hapësirat e dedikuara publike si parqet, muzetë, memorialet, etj., njihen si dëmshpërblime simbolike.

Ndarja e dëmshpërblimeve sipas formës së ofrimit:

Kompensimi: Kompensimi është forma më e shpeshtë e dëmshpërblimeve në kuadër të të cilit hyjnë të gjitha pagesat monetare dhe kompensimet e tjera materiale, që iu jepen viktimave në kompensim të shkeljeve të të drejtave të njeriut, që iu janë shkaktuar.

Satisfaksioni: Satisfaksioni përfshin grupin e dëmshpërblimeve që ofrojnë një kënaqësi dhe përmbushje emocionale për viktimat e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu kërkim-faljet nga zyrtarët shtetëror, pranimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, etj.

Rehabilitimi: Masat që ofrojnë kujdes social, psikologjik dhe mjekësor konsiderohen si dëmshpërblime rehabilituese.

Kthimi në gjendjen e mëparshme: Kthimi në gjendjen e mëparshme i referohet atyre masave që synojnë rivendosjen e statusit të mëparshëm të viktimave. Këto masa mund të përfshijnë rivendosjen e të drejtave, si: shtetësia, liria, kthimi i pronës, kthimi në punë e deri tek kthimi i pronës publike dhe private të plaçkitur gjatë luftës apo gjatë sistemeve autoritare.

Ofrimi i dëmshpërblimeve në Kosovë

Pas luftës në Kosovë, dëmshpërblimet për viktimat e luftës kanë marrë kryesisht formën e pensioneve mujore të ofruara nga qeveria e Republikës së Kosovës. Këto pensione, fillimisht të rregulluara nga UNMIK-u dhe pastaj sipas ligjeve të Kosovës, ofrojnë mbështetje financiare për individët që kanë qenë viktimat të shkeljeve masive të drejtave të njeriut gjatë luftës në Kosovë. Sa i përket dëmshpërblimeve në bazë të vendimeve gjyqësore, numri i kompensimeve të tilla mbetet relativisht i ulët, me vetëm një numër të kufizuar të dhënë nga Republika e Serbisë për shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga forcat e saj të armatosura. Kompensime të tilla zakonisht ndiqen përmes procedurave civile gjyqësore, të cilat inicohen pas një vendimi përfundimtar penal që shpall fajtor një individ.

Përveç këtyre, masat rehabilituese janë të përshkruara në ligje të ndryshme brenda Kosovës, duke synuar përfituesit siç janë viktimat e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin (CRSV), individët e luftës dhe veteranët. Këto masa synojnë të adresojnë pasojat afatgjata fizike, psikologjike dhe sociale të konfliktit, duke ofruar mbështetjen dhe burimet e nevojshme për individët e prekur. Sa i përket dëmshpërblimeve simbolike, shumë shkolla, rrugë, institucione edukative, parqe dhe hapësira të tjera publike janë emëruar në nder të viktimave të ndryshme, duke shërbyer si përkujtimore të qëndrueshme. Për më tepër, data specifike, si 27 Prilli si Dita Kombëtare e Personave të Zhdukur dhe 14 Prilli si Dita Kombëtare e të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës në Kosovë, shërbejnë si përkujtues të angazhimit të vazhdueshëm për të kujtuar dhe nderuar të prekurit nga lufta.

2.3.4 Reformat Institucionale

Në trajtimin e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut dhe të trashëgimisë së konflikteve, është e domosdoshme

që në mënyrë fundamentale të ndryshohen ato institucione përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të njeriut, me qëllim të ripërtëritjes së sundimit të ligjit dhe të heqjes së kulturës së mosndëshkimit. Për arsye se institucionet publike (siç janë policia, ushtria dhe gjyqësia) shpesh bëhen instrumenti i shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë konflikteve, është thelbësore pas tranzicionit për të filtruar dhe reformuar ato. Reforma institucionale është, së këndejmi, proces i rindërtimit të shtetit, me qëllim që t'i përmbahet respektimit të normave të të drejtave të njeriut dhe dispozitave të sundimit të ligjit si dhe spastrimit nga kryerësit e veprave penale për të siguruar llogaridhënien individuale dhe për të siguruar mospërsëritjen. Qëllimi i reformës institucionale brenda DT-së është që qytetarëve t'iu dërgohet mesazhi se ata janë bartës të të drejtave dhe për të ndërtuar besimin midis tyre dhe institucioneve të tyre.

Llojet e reformave institucionale:

Çarmatimi, Demobilizimi dhe Ri-integrimi: Në kuadër të këtij procesi përfshihet shpërbërja e aktorëve të ndryshëm të armatosur, përfshirë këtu grupet guerile apo grupet paramilitare, çarmatosja e të njëjtëve dhe krijimi i kushteve të favorshme për ri-integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe familjare.

Në rastin e Kosovës, në një proces të tillë kaloi UÇK-ja në periudhën Qershor - Shtator 1999 dhe konsiderohet një nga rastet më të suksesshme të çarmatimit, demobilizimit dhe ri-integrimit të një grupi të armatosur pas një konflikti të armatosur.

Reforma Strukturore: Reformat strukturore përfshijnë ristrukturimin e institucioneve publike për të promovuar integritetin dhe legjitimitetin e tyre, përmes sigurimit të llogaridhënies, pavarësisë, barazisë dhe gjithëpërfshirjes.

Transformimi i Kornizave Ligjore: Në kuadër të transformimit të kornizave ligjore hyjnë reformimi dhe krijimi i kornizave të reja ligjore, të cilat sigurojnë dhe garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Mbikëqyrja: Parasheh krijimin e organeve mbikëqyrëse nga institucione shtetërore në mënyre që të sigurohet përgjegjshmëri në qeverisje.

Verifikimi (vetingu): Në kuadër të verifikimit, parashihet largimi nga instituconet publike i të gjithë personave përgjegjës për shkeljen masive të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të armatosura apo që i kanë shërbyer sistemit autoritar përgjegjës për shkelje masive të të drejtave të njeriut. Përmes këtij procesi, ngritet besimi i shoqërisë drejtë institucioneve publike dhe, në anën tjetër, sigurohet mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe paanshmëria përmes shërbyesve civil pa të kaluar kriminale.

Edukimi: Gjatë konflikteve të armatosura dhe gjatë sistemeve autoritare, edukimi shpesh përdoret si një mjet propagande për të shtyrë para agjendat përkatëse shtetërore. Andaj, është e domosdoshmë që sistemi arsimor dhe kurrikulat edukative të përshtaten në mënyrë që edukimi të transformohet në një mjet që i shërben paqes së qëndrueshme. Përveç kësaj, shoqëritë në tranzicion duhet të krijojnë programe edukimi dhe trajnimi për zyrtarët shtetërorë në ngritjen e kapaciteteve të tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Reformat institucionale në Kosovë:

Më përfundimin e luftës në Kosovë, reformat institucionale kanë luajtur një rol vendimtar në stabilizimin e rajonit dhe hedhjen e themeleve për paqe dhe zhvillim të qëndrueshëm. Një arritje e rëndësishme ishte procesi i suksesshëm i Çarmatimit, Demobilizimit dhe Riintegrimit (DDR) i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), i cili filloi në muajin qershor të vitit 1999 dhe përfundoi më 20 shtator të vitit 1999. Kjo përpjekje kishte për qëllim çarmatosjen e ish-luftëtarëve, riintegrimin e tyre në jetën civile, dhe të lehtësojë kalimin e tyre në role kontribuuese brenda shoqërisë, duke reduktuar kështu rrezikun e përsëritjes së dhunës dhe duke nxitur pajtimin.

Për më tepër, Kosova e pasluftës ka hyrë në rrugën e reformave institucionale, duke përfshirë përafrimin e kornizës së saj ligjore kombëtare me standardet ndërkombëtare. Ky proces përfshin përafrimin e ligjeve dhe institucioneve vendase me normat dhe konventat ndërkombëtare, veçanërisht në fusha të tilla si të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe qeverisja. Përveç kësaj, decentralizimi është ndjekur si një reformë strukturore për të fuqizuar qeverisjen lokale dhe për të përmirësuar qeverisjen demokratike. Nëpërmjet decentralizimit, autoriteti dhe burimet vendimmarrëse iu transferohen komunave, duke lejuar një autonomi më të madhe lokale dhe reagim ndaj nevojave të komunitetit.

Për më tepër, krijimi i organeve mbikëqyrëse, siç është Inspektorati Policor, është një instrument kyç në forcimin e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes brenda institucionit të Policisë së Kosovës.

Sa i përket masave në edukim, institucionet e Kosovës në bashkëpunim dhe me ndihmën e institucioneve ndërkombëtare kanë ofruar programe të shumta edukimi për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve shtetëror në fushën e sigurimit dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Por, në anën tjetër, kanë dështuar të reformojnë dhe pasurojnë kurrikulat shtetërore në të tri nivelet e edukimit në mënyre që të promovojnë edukimin për paqe dhe të informojnë rininë lidhur me shkeljet masive të të drejtave të njeriut gjatë luftës në Kosovë dhe rreth masave që duhet të ndërmerren për t'u ballafaquar me të kaluarën dhe për të kontribuar në një paqe më të qëndrueshme. Gjithashtu, që nga përfundimi i luftës, në Kosovë nuk është zhvilluar ndonjë proces i vetingut.

2.4 Drejtësia Tranzicionale në Praktikë

Procesi i ballafaqimit me të kaluarën është një proces i ndjeshëm, i cili në praktikë duhet të marrë në konsideratë një varg faktorësh në mënyrë që të kontribuojë në paqe të qëndrueshme në mesin e shoqërive, të cilat kanë kaluar nëpër periudhat ku kanë ndodhur shkelje masive të të drejtave të njeriut.

Drejtësia Tranzicionale, si një komponent kyç në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, duhet të përqendrohet në një numër të konsiderueshëm faktorësh, të cilët do të elaborohen më poshtë.

1. Viktimat në Qendër: Një nga parimet themelore në fushën e drejtësisë tranzicionale është vendosja e viktimave në qendër të të gjitha proceseve të ndërmarrja. Një praktikë e tillë kontribuon në njohjen dhe adresimin e vuajtjeve dhe nevojave të atyre që janë prekur drejtpërdrejt nga dhuna, konflikti dhe shtypja. Kjo kontribuon, gjithashtu, në ngritjen e empatisë dhe në ndërmarrjen e masave riparuese kundrejt viktimave, jo vetëm përmes masave kompenzuese, por edhe përmes njohjes, tregimit të së vërtetës, sjelljes së drejtësisë dhe mbështetjes psikologjike. Praktika tregon që një rol kyç në përmbushjen e këtij parimi luajnë akterët jo-shtetërore, përfshirë këtu Organizatat Joqeveritare dhe Shoqatat e Viktimave/Familjarëve të Viktimave. Shkelja masive e të drejtave të njeriut lëkund besimin e qytetarëve drejtë institucioneve shtetërore dhe si pasojë forcon besimin ndaj institucioneve jo-shtetërore në ngritjen e kërkesave dhe të drejtave të tyre. Në këtë mënyrë, akterët jo-shtetërore shndërrohen në avokues për realizimin e këtyre kërkesave dhe të drejtave të viktimave dhe familjarëve të viktimave.

2. Vullneti Politik: Drejtësia tranzicionale është një përpjekje sfiduese, e cila kërkon një angazhim të madh dhe kuptimplotë nga udhëheqja politike në bashkëpunim me akterët tjerë relevant. Shprehja e vullnetit të fortë politik për të nisur, lehtësuar dhe mbështetur proceset e ballafaqimit me të kaluarën, përveç rezultateve më të mëdha dhe realizimit të të drejtave dhe nevojave të viktimave të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, kontribuon, po ashtu, edhe në ngritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore dhe në krijimin e një fryme institucionale demokratike dhe paqësore.

3. Komplementariteti/bashkërendimi i Shtyllave të Drejtësisë Tranzicionale: Siç u theksua më lartë, Drejtësia Tranzicionale përfshin një varg mekanizmesh, të cilët funksionojnë në kuadër të katër shtyllave të saj dhe, si tërësi, kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të drejtësisë tranzicionale, përfshirë komisione të së vërtetës, gjykime penale, kompensime dhe reforma institucionale.

Andaj, është e rëndësishme që të gjithë mekanizmat si tërësi të veprojnë në bashkërendim dhe plotësim të njëri-tjetrit dhe jo si të vetëm. Mungesa e bashkërendimit të iniciativave dhe mekanizmave, që në fokus kanë ballafaqimin me të kaluarën, mund ta dëmtojë procesin si të tillë dhe të sjellë rezultate kontraverse.

4. Rëndësia e Kontekstit: Mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale nuk mund të funksionojnë sipas një formule standarde në të gjitha shoqëritë post-autoritare apo pas konflikteve. Përkundrazi, është e domosdoshme të merren parasysh një numër faktorësh të veçantë historik, kulturor, shoqëror dhe politik, të cilët ndikojnë në zgjedhjet dhe strategjitë e përdorura në çdo rast të veçantë. Një qasje universale rrallë është efektive dhe, së këndejmi, zgjidhjet e përshtatura janë të nevojshme për të arritur paqe dhe pajtim të qëndrueshëm.

5. Përbërja e Popullsisë: Së fundi, është e rëndësishme të konsiderohet ndikimi i demografisë së popullsisë në drejtësinë tranzicionale. Etnia, kultura, arsimi, raca dhe situata ekonomike e një popullsie mund të ndikojnë ndjeshëm në natyrën e konfliktit, si dhe masat e nevojshme për shërimin dhe rindërtimin.

2.5 Burime rreth Drejtësisë Tranzicionale

Institucione Ndërkombëtarë dhe Vendore

Tribunali Penal Ndërkombëtarë për ish-Jugosllavinë <https://www.icty.org/>

Tribunali Penal Ndërkombëtarë për Ruandën <https://unictr.irmct.org/>

Mekanizmi Ndërkombëtar Residual për Tribunalet Penale <https://www.irmct.org/en>

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës <https://www.scp-ks.org/sq>

Prokuria Speciale e Republikës së Kosovës <https://prokuroria-rks.org/psh/prokuroria-speciale/43/pr-ne>
Departamenti për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit (Ministria e Drejtësisë e Kosovës)
<https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,162>

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur i Republikës së Kosovës <https://kryeministri.rks-gov.net/zyra-e-kryeministrit/zyrat/komisioni-qeveritar-per-persona-te-zhdukur/>

Agjencia për Menaxhimin e Memorialeve <https://amkkm.rks-gov.net/>

Organizata Jo-Qeveritare

Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale <https://www.ictj.org/>

Qendra për Drejtësi Tranzicionale dhe Rindërtim Pas konfliktit <https://tjcentre.uwo.ca/>

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë <https://www.hlc-kosovo.org/en>

Fondi për të Drejtën Humanitare <http://www.hlc-rdc.org/?lang=de>

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Troturës <https://krct.org/>
Integra <https://ngo-integra.org/>

Qendra e Drejtësisë Tranzicionale SENSE <https://sensecentar.org/index.php/>

Hulumtime

IDEA, “Truth - Telling”, In reconciliation After Violent Conflict: A Handbook (2003) chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.idea.int/sites/default/files/publications/reconciliation-after-violent-conflict-handbook.pdf

IDEA, Traditional Justice and Reconciliation after Violent Conflict [traditional-justice-and-reconciliation-after-violent-conflict-learning-from-african-experiences_0.pdf](#) (idea.int)

International Center for Transitional Justice, Truth Sëking: Elements of Creating an Effective Truth Commission (2013) [TruthSëking_Insides_English.indd \(ictj.org\)](#)

OHCHR, Study on the Right to Truth, E/CN.4/2006/91 (2006) [g0610656.pdf \(un.org\)](#)

Janine Natalya Clark, Rape, Sexual Violence and Transitional Justice Challenges: Lessons from Bosnia Herzegovina, Oxon, New York 2018 <https://www.routledge.com/Rape-SexualViolence-and-Transitional-Justice-ChallengesLessons-from/Clark/p/book/9780367191788>

Léa Lemay Langlois, “Gender Perspective in UN Framework for Peace Processes and Transitional Justice: The Nöd for a Clearer and More Inclusive Notion of Gender,” in International Journal of Transitional Justice 12:1 (2018), 146-167.

Catherine O’Rourke, “Transitional Justice and Gender”, in Research Handbook on Transitional Justice, ed. by Cheryl Lawther, Luke Moffet, Dov Jacobs, Cheltenham, 2017, 117-141
ICTJ, Disarmament, Demobilization and Reintegration, [Disarmament, Demobilization, and Reintegration | International Center for Transitional Justice \(ictj.org\)](#)

Dokumente

Basic Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/basic-principles-and-guidelines-right-remedy-and-reparation>

Rule of Law Tools for Post-Conflict States, United Nations [RuleoflawMonitoringen.pdf \(ohchr.org\)](#)

International Nuremberg Principles Academy, Learning Manual – Acceptance of International Criminal Justice [Learning_Manual_10_09_16_komplett_Online_auf_Einzelseiten.pdf \(nurembergacademy.org\)](#)

DCAF, Vetting and the Security Sector (2006) [Vetting and the Security Sector \(ethz.ch\)](#)

United Nations, Report of Special Rapporteur on the promotion of truth, justice, reparation and guarantees of non-recurrence, Pablo de Greiff (2015) [Report of the Special Rapporteur on the promotion of truth, justice, reparation and guarantees of non-recurrence, Pablo de Greiff \(un.org\)](#)

UN Security Council Resolution 2467 (2019), 23 April 2019, S/RES/2467 (2019) (On women and peace and security: sexual violence in armed conflict) [n1911828.pdf \(un.org\)](#)

UN Security Council Resolution 2106 (2013), 24 June 2013, S/RES/2106 (2013) (On sexual violence in armed conflict) [n1911828.pdf \(un.org\)](#)

UN Security Council Resolution 1325 (2000), 31 October 2000, S/RES/1325 (2000). (On women and peace and security) [n0072018.pdf \(un.org\)](#)

Strategji

African Union Transitional Justice Framework (2015) [legal-tools.org/doc/bcdc97/pdf/](#)

European Union, EU Policy on Support to Transitional Justice (2015) [the_eu_policy_framework_on_support_to_transitional_justice.pdf \(europa.eu\)](#)

Ligje Relevante të Kosovës rreth njohjes se statutit të kategorive të ndryshme të luftës 1998-1999

Ligji nr. 04/l-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2793>

Ligji nr. 04/l-172 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2793>

Ligji nr. 04/l -261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9435>

Ligji nr. 03/l-95 për të drejtat e ish të denuarve dhe të përndjekurve politikë <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2738>

Ligji nr. 04/l-023 për persona të zhdukur <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2765>

Ligji nr. 04/l-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517&langid=2>

Rreth realizimit te drejtës për drejtësi

Ligji nr. 03/l-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të eulex-it në Kosovë <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2527>

Ligji nr. 08/l-168 për prokurorinë speciale <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84236>

Ligji nr. 05/l-053 për dhomat e specializuara dhe zyrën e prokurorit të specializuar <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036>

Ligji nr. 08/l-002 për plotësimin dhe ndryshimin e kodit nr. 04/l-123 të procedurës penale i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 06/l-091 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=43260>

Rreth realizimit të se drejtës për të ditur të vërtetën

Ligji nr. 08/l-177 për institutin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=79157>

Ligji nr.03/l-137 për departamentin e mjekësisë ligjore <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2646>

Rreth memorializimit

Ligji nr. 04/l-146 për agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8657>

Ligji nr. 06/l-059 për kompleksin memorial “Adem Jashari” në Prekaz <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18130>